



# **Kosova pa Strategji kundër Korrupsion** (Dështimi i Qeverisë për miratimin e Strategjisë kundër Korrupsion dhe Komentet e IKD lidhur me Draft Strategjinë kundër Korrupsion)



Autor: Gzim Shala

Redaktor: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e NED-it dhe RBF.*

## RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

v

## IKD

Rr. Ilaz Agushi  
Prishtinë  
E: [info@kli-ks.org](mailto:info@kli-ks.org)  
[www.kli-ks.org](http://www.kli-ks.org)

Përkrahur nga:



Janar 2024  
Prishtinë, Republika e Kosovës

## Përmbajtja

1. Hyrje.....	4
2. Koment i përgjithshëm .....	6
3. Papërshtatshmëria e masave për mbrojtjen e sinjalizuesve .....	7
4. Qasja e OShP në dosje penale.....	8
5. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës .....	9
6. Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve.....	9
7. Ligji për Evidencë Penale .....	10
8. Publikimi i orarit të seancave.....	11
9. Deklarimi i konfliktit të interesit.....	11
10. Trajtimi i kallëzimeve penale.....	11
11. Kryetari i Gjykatës Komerciale.....	12
12. Mbikëqyrja e Gjykatës Kushtetuese .....	13
13. Byroja Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme .....	14
14. “Mungesa” e ligjit për pronësinë përfituese dhe pronësia mediale .....	14
15. Plani i veprimit .....	16
16. Rekomandime:.....	17

## 1. Hyrje

Luftimi i korrupsionit ka qenë njëra prej premtimeve kryesore me të cilat ka ardhë në pushtet Lëvizja Vetëvendosje. “Drejtësi dhe Punësim” ishte sllogani kryesor i kësaj partie gjatë fushatës elektorale. Kur Qeveria Kurti II po bënë tri vite që nga ardhja në pushtet, reformat e mëdha si Vetingu në Sistemin e Drejtësisë, Reforma në sistemin prokurorial, reforma në drejtësinë civile përmes miratimit të Kodit Civil etj, ende nuk janë jetësuar.

Edhe përkundër faktit se Qeveria Kurti II luftimin e korrupsionit e kishte proklamuar si qëllimin kryesor, në fundin e vitit të tretë të qeverisjes, Kosova ende nuk ka një Strategji për Luftimin e Korrupsionit dhe publiku ende nuk e ka të qartë se cila do të jetë rruga që Qeveria do të ndjek në raport me luftimin e korrupsionit në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësiive që kjo qeveri ka në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Mungesa e kësaj Strategjie për një kohë kaq të gjatë dhe dështimi i grupit punues për të hartuar një dokument të bazuar në ligjin e aplikueshëm në Kosovë, dhe i cili dokument nuk ndërhyr në pavarësinë dhe integritetin e institucioneve të pavarura, ndërton bindjen se vet qeveria dhe grupi punues kanë probleme serioze për të kuptuar kompetencat e tyre dhe për të përmbushur obligimet që dalin nga Programi i Qeverisë për luftimin e korrupsionit.

Ligji Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit ka hyrë në fuqi në Gusht të vitit 2022. Strategjia shtetërore dhe plani i veprimit kundër korrupsionit në përputhje me nenin 24 të këtij Ligjit hartohet dhe miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Përderisa, zbatimin e Strategjisë kundër korrupsionit, e monitoron Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 22 shkurt 2023 kishte marrë vendim për themelimin e strukturave për hartimin e Strategjisë Shtetërore dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit. Kjo strukturë përbëhej prej Komisionit Ministror, Koordinatorit dhe Grupit punues. Me ç’rast grupi punues përbëhej prej akterëve të rëndësishëm shtetëror, duke përfshirë dhe agjencitë e pavarura dhe institucionet tjera sipas nevojës. Ky grup punues, sipas këtij vendimi, duhej ta draftonte këtë Strategji deri më 1 dhjetor 2023.

Përgjatë kohës sa është hartuar Draft Strategjia Kombëtare kundër Korrupsionit dhe Planit i Veprimit 2023-2026 (Tutje: *Draft Strategjia*) IKD ka marrë pjesë në të gjitha takimet ku është ftuar si dhe ka dërguar edhe komentet me shkrim, duke synuar dhënien e kontributit drejt hartimit të një Strategjie që i përgjigjet nevojës për luftimin e korrupsionit. Përkundër kësaj, narrativi i Draft Strategjisë u bë i njohur për IKD vetëm në takimin e datës 7 nëntor 2023, gjatë të cilit takim, fillimisht, u tha se ishte i takimi i fundit lidhur me këtë Draft Strategji. IKD dha komentet e saj në këtë takim

dhe të njëjtat i procedoj edhe me shkrim. IKD nuk morri asnjëherë përgjigje mbi mënyrën e trajtimit të këtyre komenteve.

Fatkeqësisht, as pas datës 1 dhjetor 2023, kur sipas vendimit të Qeverisë Strategjia do duhej të hartohej, përgjigje nuk pranoi as publiku se pse nuk mjaftuan mbi 9 muaj që të hartohej dhe finalizohet kjo Strategji, edhe përkundër faktit se miratimi i kësaj Strategjie mbetet obligim ligjor.

Në këtë dokument, IKD paraqet komentet e saja në Draft Strategji, të cilat i'a ka dërguar me shkrim Zyrës së Kryeministrit, për të cilat komente IKD asnjëherë nuk ka marrë informata kthyesë mbi mënyrën e trajtimit të tyre.



## 2. Koment i përgjithshëm

IKD pas analizës së draftit të Strategjisë ka vërejtur se të njëjtës i mungon argumentimi i çështjeve të cilat janë subjekt i trajtimit në Strategji. Vetëm përjashtimisht dhe vetëm në terma të përgjithësuar Draft Strategjia citon ndonjë raport. Mirëpo, Draft Strategjia nuk e përshkruan çështjen dhe problemin përmes të dhënave empirike dhe analitike, nuk përdor dokumente të tjera mbështetëse, analiza apo dokumente të miratuara që ndërlidhen me çështjet e trajtuara në Strategji. Kryesisht, në tërësinë e saj, Draft Strategjia e abstrahon nevojën për argumentimin e problemeve të cilat i pretendon. Kështu, edhe aktivitetet e listuara në Planin e Veprimit të Draft Strategjisë nuk rrjedhin nga një rrjedhë logjike, që aktiviteti të ishte me masa për evitimin e problemeve të identifikuar, provuara, analizuar dhe argumentuara. Në çështjet të cilat janë objekt trajtimi i këtij dokumenti paraqitet qartazi mungesa e kësaj qasje.

Vet Draft Strategjia nënvizon se “Qeveria e ka udhëhequr procesin dhe e ka bazuar Strategjinë në qasjen e bazuar në risk”. Mirëpo, argumentimi i kësaj qasje nuk vërehet pothuajse në tërë Draft Strategjinë.

Qeveria e Kosovës ka miratuar Strategjinë për Sundimin e Ligjit. Kjo strategji ka derivuar nga Procesi i Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit, i cili proces ka skanuar të gjitha çështjet që ndërlidhen me sundimin e ligjit, përfshirë edhe parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Gjetjet e këtij procesi, shoqëruar me hulumtimin tutje të aspekteve të caktuara, do të ishin bazë e mirë për argumentimin e çështjeve relevante në Draft Strategji. Por, kjo Draft Strategji nuk i referohet fare Strategjisë për Sundim të Ligjit dhe as dokumenteve të politikave të dala nga Procesi i Rishikimit Funkcional të Sektorit të Sundimit të Ligjit.

Në anën tjetër, në shumë raste, ka pasaktësi faktike që e bëjnë këtë Draft Strategji të paqëndrueshme. I tillë p.sh është rasti kur thuhet se nuk ekzistojnë dispozita për obligueshmërinë e kthimit të përgjigjeve lidhur me rezultatin e kallëzimeve penale, mungesës së dispozitave lidhur me pronarin përfitues etj. Apo, është rasti kur thuhet se disa probleme do të trajtohen përmes Ligjit për Evidenca Penale, ku më pastaj përfshihen edhe çështje të cilat fare nuk kanë të bëjnë me këtë Ligj.

Në anën tjetër, Draft Strategjia ka po ashtu probleme lidhur me mënyrën se si i trajton disa prej koncepteve. I tillë është rasti lidhur me monitorimin e punës së KGJK dhe KPK nga Gjykata Kushtetuese apo përzierja e koncepteve lidhur me pronarin përfitues dhe pronësinë mediale. Përkundër faktit se Draft Strategjia e nënvizon nevojën që të shtrihet vetëm në ato segmente që mund të trajtohen nga mekanizmat dhe mjetet qeveritare, pikërisht e njëjta Draft Strategji përmban çështje të cilat janë në kompetencë të institucioneve të sistemit të drejtësisë.

Në anën tjetër, në disa raste, Draft Strategjia përmend çështje të cilat tanimë kanë përfunduar. Ndërsa, supozohet se Draft Strategjia dhe Plani i Veprimit të shtrihen vetëm në të ardhmen dhe jo të trajtojnë çështje që tanimë kanë përfunduar.

Të gjitha këto çështje janë të elaboruara në detaje në vijim të këtij dokumenti.

Me qëllim të ndërtimit të një Strategjie adekuate kundër Korrupsionit, Qeveria me vendimin e saj ka themeluar strukturat për hartimin e kësaj Strategjie. Përtej vetëm draftimit narrativ të Draft Strategjisë, supozohej se këto struktura do të zhvillonin hulumtim adekuat, në mënyrë që të draftohet një Strategji e bazuar në evidencë, analizë dhe argumente. Kjo qasje nuk duhet se është ndjekur në rastin e kësaj Draft Strategjie.

Për këtë arsye, IKD vlerëson se pas adresimit të çështjeve si në vijim, Draft Strategjia duhet ti nënshtrohet ridraftimit dhe rikomentimit, në mënyrë që e njëjta të ndjekë standardet e kërkuara. Konsultimi meritator me të gjithë anëtarët e grupeve punuese dhe palët e interesit mbetet thelbësor, derisa nevoja për zhvillimin e konsultimeve publike, në përputhje me Rregulloren për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimeve Publike, obligim.

### **3. Papërshtatshmëria e masave për mbrojtjen e sinjalizuesve**

Në faqe 7 të Draft Strategjisë theksohet se "...administrata publike nuk mund të funksionojë në mënyrë eficiente pa mekanizmat për sinjalizim, të cilët: 1) sigurojnë zbatimin e ligjit për sinjalizuesit dhe 2) sigurojnë mjete digjitale lehtësisht të qasshme për raportimin e korrupsionit ose formave të tjera të keqpërdorimit dhe shkeljeve në radhët e administratës publike..".

Sa i përket platformës digjitale, fillimisht duhet theksuar se nuk ka ndonjë raport që e thekson se zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve sfidohet nga mungesa e mjeteve digjitale për sinjalizim. Këto të dhëna nuk paraqiten as në Draft Strategji. Sidoqoftë, përkundër kësaj, prapë se prapë krijimi i një platforme të tillë është diçka pozitive dhe si e tillë duhet të mbetet në Draft Strategji.

Ndërsa, sa i përket zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, IKD pajtohet me atë që thuhet në Draft Strategji mbi rëndësinë e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Sidoqoftë, Draft Strategjia në këtë rast kufizohet në theksimin e rëndësisë dhe nuk paraqet as të dhëna dhe as veprime të tjera që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij Ligji. Qartazi, vetëm ndërtimi i platformës për sinjalizim nuk është i mjaftueshëm për këtë qëllim.

Organizatrat e shoqërisë civile kanë draftuar raporte të shumta lidhur me sfidat që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Mungesa e kushteve

teknike për zbatimin e këtij Ligji është një nga çështjet me të cilat sfidohet zbatimi i këtij ligji (Shih për më tepër raportin [Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve - sfidat e zbatimit në praktikë](#); shih, gjithashtu raportin [Sinjalizimi dhe mbrojtja e sinjalizuesve](#)). Kështu, janë një sërë masash që duhet ndërmarrë në drejtim të ngritjes së efikasitetit për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Ky qëllim nuk mund të reduktohet vetëm në digjitalizimin e këtij procesi.

Për këto arsye, me qëllim të përcaktimit të masave konkrete që kanë të bëjnë me ngritjen e efikasitetit të zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, duhet të shqyrtohen dokumentet relevante që kanë bërë monitorimin e zbatimit të këtij Ligji dhe pas shqyrtimit të çështjes duke u bazuar në të dhëna konkrete, të specifikohen edhe veprimet që duhet ndërmarrë.

#### **4. Qasja e OShP në dosje penale**

Në faqen 16 të Draft Strategjisë thuhet se "...do të zhvillohet një zgjidhje e TI-së për t'u lejuar organeve të prokurimit publik qasje në dosjet penale, duke u lejuar kështu që të identifikojnë pronarët e bizneseve dhe bizneset që duhet të eliminohen nga tenderët e prokurimit publik...".

Të dhënat nga evidenca penale konsiderohen të dhëna të ndjeshme personale (Shih Ligji NR. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, neni 3.1.1.15). Me qëllim të mbrojtjes së këtyre të dhënave, janë përcaktuar dispozita specifike në kapitullin IX të Kodit NR. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës. Neni 98 i këtij Kodi flet për përmbajtjen dhe zbulimin e të dhënave nga dosja penale.

Përcaktimi i mundësisë së një institucioni që në mënyrë automatike të ketë qasje në të dhënat nga evidenca penale cenon në thelb të dhënat personale. Për më tepër, përtej procedurave konkrete, mundësia e lehtë për tu qasur në këto të dhëna cenon në thelb dispozitat që kanë të bëjnë me detyrimin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në rastin e tenderëve publik, autoritetet kontraktuese mjafton që si kriter ta fusin deponimin e certifikatës nga evidenca penale, përmes të cilës shihet nëse një subjekt është i dënuar apo jo. Kjo situatë pos që mundëson arritjen e qëllimit të synuar, nuk cenon të dhënat personale dhe sistemin për mbrojtjen e këtyre të dhënave. Për më tepër, në rastin konkret, përmes deponimit të certifikatës në fjalë, vet subjekti i të dhënave jep pëlqimin për qasje në këto të dhëna.

Për këtë arsye, IKD rekomandon që kjo çështje të fshihet nga Draft Strategjia si dhe plani i saj i veprimit.



## 5. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Në faqen 10 të Draft Strategjisë thuhet se “Për fundi, qeveria ka vënë në dukje imunitetin absolut që u është dhënë pozitave të caktuara në kuadër të shërbimit publik në vendimmarrje, gjë që në përgjithësi e dëmton administratën dhe lejon shtigje për paligjshmëri dhe keqpërdorime. Në veçanti, Këshilli Mbikëqyrës për Shërbimin Civil ka imunitet absolut në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me çështjet që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës së zyrtarëve publikë. Andaj, qeveria ka miratuar ndryshimet legislative në Ligjin për Këshillin Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, të cilat e ndalojnë imunitetin në vendimmarrje dhe, rrjedhimisht, rrisin llogaridhënien e institucioneve publike”.

Fillimisht, duhet theksuar faktin se Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit për Shërbimin Civil të Kosovës është shembull negativ lidhur me reformën në administratën e Drejtësisë. Kjo pasi ky Ligj cenon barazinë para ligjit të zyrtarëve civil dhe e bënë praktikisht jo funksional një institucion kushtetues siç është Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (Shih për më tepër raportin [Tendencat për politizim të KPMSHCK](#) dhe [Reagimin e IKD-së](#)). Ky ligj aktualisht është duke u shqyrtuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, nuk qëndron fakti se anëtarëve e këtij Këshilli kanë imunitet absolut. Imuniteti në rastin konkret është imunitet funksional, që konceptualisht dallon nga imuniteti absolut. Kjo është sqaruar mjaftueshëm, pikërisht për rastin konkret, nga Gjykata Kushtetuese (Shih rastin e Gjykatës, [nr. KO171/18, me parashtrues avokatin e popullit, aktgjykim i 20 majit 2019](#), par.252-245).

Duke abstrahuar të gjitha këto, përballë këtij narrativi të Draft Strategjisë, kjo nuk është përkthyer në asnjë aktivitet të Draft Strategjisë. Madje, nisur nga fakti se Projektligji në fjalë, i cili është duke u shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese, tanimë është miratuar, Qeveria më nuk ka objekt për planifikim strategjik. Draft Strategjia supozohet ti referohet të ardhmes, veprimeve që do të ndërmerren, dhe jo veprimeve tanimë të ndërmarra.

## 6. Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve

Në faqen 11 të Draft Strategjisë thuhet se “Një pengesë e konsiderueshme për eficiencën e përgjithshëm të sistemit gjyqësor është përdorimi i duhur i Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL). SMIL-i, një investim substancial nga Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë, u dizajnuar për të sjellë ndryshime operacionale në funksionimin e përditshëm të gjykatave. Pavarësisht se është në përdorim prej disa vitesh, SMIL-i nuk ka arritur ende të rrisë eficiencën e sistemit

gjyqësor dhe të sigurojë transparencën e vendimmarrjes dhe funksionimit të tij”, derisa në Planin e Veprimit si aktivitet listohet “Propozimi për inicimin legjislativ për SMIL-in”.

Përdorimi i SMIL deri më tani ka avancuar konsiderueshëm, përkundër problemeve teknike me të cilat vazhdon të përballet ky sistem. Nuk ka asnjë të dhënë, ashtu siç nuk ipen as në Draft Strategji se ky problem derivon në mungesë të ndonjë norme ligjore apo për shkak të ndonjë norme jo adekuate. Për më tepër, vet Draft Strategjia nuk e specifikon se cili Ligj do të miratohet në këtë drejtim. Për këtë arsye, kjo çështje për qëllime të Draft Strategjisë është pa objekt. Andaj, IKD rekomandon që kjo pjesë të largohet nga Draft Strategjia.

## **7. Ligji për Evidencë Penale**

Në faqet 11-12 të Draft Strategjisë thuhet se “qeveria do të vazhdojë me miratimin e Ligjit për Sistemin Qendror të Evidencës Penale, i cili do të sigurojë respektimin absolut të sistemit në punën e përditshme të gjykatës. Ky ligj do të sigurojë garanci minimale dhe do të lejojë që a) përdoruesit e gjykatave dhe qytetarët të kenë qasje në sistem për të gjetur informacion për lëndët e tyre; 2) gjyqtarët të jenë të obliguar t’i publikojnë datat kur u është caktuar lënda dhe të veprojnë në mënyrë eficiente për caktimin e seancave fillestare (e njëjta vlen edhe për prokurorët); 3) përmes mundësive që ofron nënshkrimi elektronik, avokatët do të mund t’i dorëzojnë online materialet e tyre mbrojtëse; 4) gjyqtarët dhe prokurorët të jenë të detyruar t’i deklarojnë konfliktet e mundshme të interesit dhe të veprojnë në përputhje me rrethanat; 5) Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës të jenë në gjendje ta përcjellin në mënyrë elektronike menaxhimin e një lënde nga një gjyqtar/prokuror dhe të bazojnë vlerësimin e performancës dhe masat e mundshme disiplinore në të dhënat e prodhuara; 6) Ministria e Drejtësisë të ketë qasje në të dhënat përfundimtare të prodhuara (numrin e aktgjykimeve të nxjerra për një kohë të caktuar) për t’i planifikuar politikat e veta në përputhje me rrethanat; dhe përmes këtyre masave qytetarët do të rifitojnë besimin në institucionet e drejtësisë”.

Shumica e këtyre çështjeve nuk kanë të bëjnë fare me Ligjin për Evidencë Penale. Publikimi i seancave, nënshkrimi elektronik, deklarimi i konfliktit të interesit etj. nuk kanë të bëjnë me Ligjin për Evidencë Penale. Kjo çështje duhet të reflektohet në Draft Strategji, në atë mënyrë që të saktësohet se cilat çështje synohet që të adresohen përmes këtij Ligji.

Në lidhje me këtë, në faqe 13 thuhet se Qeveria “[d]o të miratojë Ligjin për Sistemin Qendror të Evidencës Penale”. Me 26 tetor 2023, Kuvendi i Republikës së Kosovës

tanime ka miratuar kete ligj. Penderisa Draft Strategjia supozohet ti referohet te ardhmes, nuk do duhej te permbante ceshtje tanime te perfunduara.

#### **8. Publikimi i orarit te seancave**

Ceshtja e publikimit te seancave gjyqesore permendet ne faqen 11 te Draft Strategjise. Te dhënat nga monitorimi i IKD deshmojne se kjo ceshtje eshte problem. Por se, problematika nuk derivon nga mungesa e normave ligjore, por nga mungesa e respektimit adekuat te obligimit te percaktuar me nenin 10 te Rregullores per Organizimin dhe Veprimtarine Brendshem te Gjykatave te Republikës së Kosovës.

Keshtu, i takon KGJK qe brenda mekanizmave te vet ta adresojë kete ceshtje dhe nuk ka objekt ne ate se cfare Qeveria mund te bëjë ne kete drejtim.

#### **9. Deklarimi i konfliktit te interesit**

Ne faqe 12, Draft Strategjia thekson nevojën qe "gjyqtaret dhe prokuroret te jene te detyruar t'i deklarojne konfliktet e mundshme te interesit dhe te veprojne ne perputhje me rrethanat".

Ky detyrim per gjyqtaret tanime ekziston. Kodi i Procedures Penale percakton bazat per perjashtimin e gjyqtareve dhe prokuroreve, procedurat per perjashtim, kerkesa per perjashtim etj. Pertej kesaj, ekziston edhe Ligji per Nr. 06/L -011 per Parandalimin e Konfliktit te Interesit ne Ushtrimin e Funksionit Publik, qe percakton dispozitat qe kanë te bene me konfliktin e interesit, procedurat, deklarimin, menaxhimin e konfliktit te interesit, autoritetet pergjegjese etj. Per kete arsye, kjo ceshtje eshte mjaftueshem e rregulluar. Ne mungese te pasqyrimin te nje nevoje konkrete per plotesimin apo ndryshimin e rregullativës aktuale, kjo ceshtje tanime mbetet pa objekt. Andaj, IKD rekomandon qe kjo ceshtje te fshihet nga Draft Strategjia.

#### **10. Trajtimi i kallzimeve penale**

Ne faqe 12 te Draft Strategjise thuhet se "rastet e shumta te kallzimeve penale, ne vecanti ato qe vijne nga qeveria, nuk jane adresuar asnjehere nga Prokuroria dhe as nuk eshte dhene shpjegim se pse nuk jane ndermarre veprime. Kjo do te zgjidhet permes ketij ligji, duke u dhene pergjigje ne kohe e duhur te gjithë qytetarëve qe iniciojne kallzime penale, duke e rikthyer besimin e qytetarëve ne institucionet e drejtesise si dhe duke siguruar transparencën dhe eficiencën e tyre.

Kjo ceshtje eshte e pasakte ne faktet e saj. Krahas neneve te tjera, neni 84 i Kodit nr. 08/L-032 te Procedures Penale e sakteson procedurën e hedhjes se kallzimit penal.

Ndër të tjera, paragrafi 4 i këtij neni specifikon se “[b]renda tetë (8) ditësh nga hedhja e kallëzimit penal, prokurori i shtetit ia dërgon aktvendimin me arsyet për hedhjen e kallëzimit penal të dëmtuarit ose viktimës, personit apo organit që ka parashtruar kallëzimin penal. Aktvendimi për hedhjen e kallëzimit penal i dorëzohet edhe personit kundër të cilit është ngritur kallëzimi penal”. Ndër të tjera, në këtë nen përcaktohet edhe mundësia e ankimimit në Prokurorinë e Apelit në rast të hedhjes së kallëzimit penal [paragrafi 5] apo në rast të mos veprimit brenda gjashtë muajve [paragrafi 8]. Për këtë arsye, nuk qëndron ajo se nuk ka dispozita që përcaktojnë obligimin e Prokurorisë për të njoftuar palën lidhur me rezultatin e trajtimit të një kallëzimi penal.

Tutje, në këtë paragraf thuhet se “...kjo do të zgjidhet përmes këtij ligji...”. Nuk është e qartë se për cilin ligj e ka fjalën këtu Draft Strategjia. Në paragrafin paraparak trajtohet Ligji për Evidencë Penale, që qartazi nuk ka të bëjë me këtë çështje.

Për më tepër, kritika në drejtim të Prokurorit të Shtetit në këtë rast është në linjë me deklaratimet e vazhdueshme të Qeverisë në drejtim të sistemit të drejtësisë, të cilat deklarime paraqesin ndërhyrje të pastër në punën e sistemit të drejtësisë. Tutje, është kontradiktore që në të njëjtin paragraf kritikohet një institucion kushtetues si Prokurori i Shtetit, e në të njëjtin paragraf synohet ngritja e besimit të publikut në institucionet e drejtësisë.

Në drejtim të avancimit të kësaj çështje, do të ishte e mirëseardhur nëse strategjia do ta listonte si aktivitet ndryshimin e Kodit të Procedurës Penale, në atë mënyrë që kontrolli të largohet nga Prokuroria e Apelit dhe të shndërrohet në kontroll gjyqësor. Kështu, do të adresohet shkelja e Kushtetutës së Republikës së Kosovës që konsiston në mungesën e qasjes në drejtësi ndaj vendimeve prokuroriale. Për këtë çështje, shih për më tepër raportet e IKD: [Luftimi i korrupsionit pa kontroll të gjyqësorit](#) dhe [\(Mos\) Zbatimi i Strategjisë së Sundimit të Ligjit në Praktikë](#), faqe.19-20.

## **11. Kryetari i Gjykatës Komerciale**

Në faqen 12 të Draft Strategjisë thuhet se “[p]ërqendrimi i juridiksioneve të gjetjes së fakteve dhe të apelit brenda një subjekti të vetëm gjyqësor dëmton kontrollet dhe balancat e brendshme. Strategjia synon të sigurojë një ndarje të qartë të roleve ndërmjet gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit, si dhe një shpërndarje të duhur të përpjekjeve për ngritjen e kapaciteteve”.

Çështja nëse Gjykata Komerciale duhet të funksionojë me një apo dy kryetarë ka qenë objekt i diskutimit të detajuar në grupin punues për draftimin e Ligjit për Gjykatën Komerciale, pas të cilit diskutim është zgjedhur modeli që Gjykata komerciale të funksionojë me dy dhoma dhe një kryetar.

Ligji për Gjykatën Komerciale ka hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2022. Kështu, Gjykata Komerciale është ende një gjykatë e re. Përtej dilemave lidhur me atë nëse Gjykata komerciale duhet të ketë një apo dy kryetarë, të cilat dilema janë trajtuar në grup punues, nuk janë shfaqur problematika të tjera. Për këtë arsye, përderisa është në fazat e saja fillestare, hyrja në proces për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Gjykatën Komerciale vetëm sa do ta dëmtonte këtë Gjykatë.

Por, nëse me të vërtetë ka arsye të fuqishme për tu bërë kjo, Draft Strategjia do duhet të përmbante të dhëna dhe argumente konkrete, gjë që nuk ka ndodhur në këtë rast.

Për këtë arsye, IKD rekomandon që kjo çështje të largohet nga Draft Strategjia.

## **12. Mbikëqyrja e Gjykatës Kushtetuese**

Në faqen 12 të Draft Strategjisë thuhet se “Modeli i përsëritur i kompleksiteteve që rrjedhin nga procesi i emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit, si dhe ndërveprimi i tij me procesin gjyqësor në Gjykatën Kushtetuese, nënvizojnë domosdoshmërinë e adresimit të çështjes së mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë kushtetuese të rregullave, rregulloreve dhe vendimeve të të dy këshillave në kuadër të sistemit gjyqësor.... Strategjia do të përfshijë masa që synojnë vendosjen e mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë kushtetuese të akteve nënligjore dhe vendimeve të sistemit gjyqësor...”. Tutje, në faqe 13 të Draft Strategjisë nënvizohet se Qeveria “...[d]o të sigurojë mbikëqyrje kushtetuese të vendimeve të miratuara nga KGJK-ja dhe KPK-ja”. Një ndër aktivitetet e përcaktuara në Planin e Veprimit të Draft Strategjisë është “Hartimi dhe miratimi i plotësim-ndryshimeve të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese për të siguruar mbikëqyrjen e rregullave dhe vendimeve të KGJK-së dhe KPK-së”.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 4 ka përcaktuar dispozitat që kanë të bëjnë me ndarjen e pushteteve. Përballë pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe atij gjyqësor, janë dy institucione të cilat funksionojnë jashtë kësaj ndarje: Presidenti i Republikës së Kosovës dhe Gjykata Kushtetuese. Kështu, përcaktimi i Gjykatës Kushtetuese si institucion mbikëqyrës i institucioneve të sistemit të drejtësisë është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Për më tepër, ky model i përcaktuar në Draft Strategji është po ashtu në kundërshtim me vet konceptin e gjyqësisë kushtetuese. Neni 4.6. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se “Gjykata Kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës”, ndërsa neni 113.1. i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se “Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”. Kështu, nuk është në natyrën e një institucioni si Gjykata Kushtetuese që të shërbejë si organ mbikëqyrës i një institucioni tjetër të KGJK dhe KPK.



Në anën tjetër, duhet theksuar se vendimet e KGJK dhe KPK nuk janë jashtë orbitës së mbikëqyrjes së Gjykatës Kushtetuese. Por, kjo mbikëqyrje ushtrohet në mënyrën se si zhvillohet drejtësia kushtetuese, përmes rasteve të iniciuara. Kështu, në secilin rast, secila prej palëve të autorizuara për të ngritur rast pranë Gjykatës Kushtetuese, mund të ngrisë rast edhe ndaj vendimit të KPK dhe KGJK. Duhet vënë këtu vëmendjen tek fakti se kjo Gjykatë ka anuluar vendimin e KPK për propozimin e Kryeprokurorit të Shtetit (Shih rastin e Gjykatës, [nr. KI99/14 dhe 100/14, me parashtrues Shyqyri Syla dhe Laura Pula, Aktgjykim i 8 korrikut 2014](#)), vendimin e KGJK për propozimin e Kryetarit të Gjykatës Supreme (Shih rastin e Gjykatës, [nr. KI34/17, me parashtrues Valdete Daka, aktgjykim i 12 qershorit 2017](#)), vendimin e KGJK për emërimin e Kryetarit të Gjykatës së Apelit (Shih rastin e Gjykatës, [nr. KI55/77, me parashtrues Tonka Berisha, Aktgjykim i 17 korrikut 2017](#)) etj. Kështu, vendimet e KGJK dhe KPK nuk përjashtohen nga juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese. Mirëpo, veprimi i Gjykatës Kushtetuese në këto raste vepron në përputhje me konceptin e funksionimit normal të Gjyqësisë Kushtetuese dhe jo përmes një modeli të panjohur në Drejtësinë Kushtetuese bashkëkohore, atë të përcaktimit të Gjykatës Kushtetuese si institucion mbikëqyrës i një institucioni tjetër.

### **13. Byroja Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme**

Në faqen 13 të Draft Strategjisë thuhet se Qeveria “Do të themelojë Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme”. Ligji për Byronë Shtetërore për Verifikimin dhe Konfiskimin e Pasurisë së Pajustificueshme tanimë është miratuar, dhe i njëjti është duke u shqyrtuar nga Gjykata Kushtetuese.

Në këtë situatë, kjo çështje tanimë është e përfunduar sa i përket rolit të Qeverisë, për faktin se Qeveria e ka sponsorizuar Projekt Ligjin tanimë të miratuar si dhe edhe nëse e supozojmë faktin se Gjykata Kushtetuese e konfirmon kushtetutshmërinë e këtij Projektligji, Qeveria nuk ka tutje rol në themelimin e Byrosë, por se rolin qëndror e mban Komisioni për Mbikëqyrjen e Byrosë. Në këtë situatë, Qeveria nuk ka objekt për planifikim të ndonjë çështje, për faktin se ky proces është proces i përfunduar.

Për këtë arsye, meqenëse kjo çështje tanimë ka përfunduar dhe Qeveria nuk ka rol tutje lidhur me këtë, IKD rekomandon që kjo çështje të largohet nga Draft Strategjia.

### **14. “Mungesa” e ligjit për pronësinë përfituese dhe pronësia mediale**

Në faqen 17 të Draft Strategjisë thuhet se “Në mungesë të ligjit për pronësinë përfituese, administrata shtetërore dhe qytetarët (përfshirë shoqërinë civile) e kanë të pamundur ta dinë se kush qëndron pas një biznesi të caktuar”. Nuk qëndron fakti se

në Kosovë ka “mungesë të ligjit për pronësinë përfituese”. Ligji Nr. 05/L -096 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimin e Financimit të Terrorizmit në nenin 2.1.1.36 përcakton dispozita detajuese lidhur me kuptimin e pronarit përfitues. Po ashtu, BQK ka miratuar edhe [Udhëzimin mbi Identifikimin e Pronarëve Përfitues](#). Kështu, ky përcaktim i Draft Strategjisë faktikisht nuk qëndron.

Nëse lidhur me çështjen e pronarëve përfitues dispozitat në fjalë kanë ndonjë problem eventual që lidhet me efektshmërinë e këtyre dispozitave apo zbatimin e tyre në praktikë, Draft Strategjia duhet që ta sqarojë këtë problem si dhe të tregojë saktësisht cilat çështje janë problematike dhe cilat dispozita ligjore duhet të plotësohen apo ndryshohen. Mirëpo, në rastin konkret vetëm është konstatuar mungesa e dispozitave lidhur me pronarin përfitues, që siç u tha, nuk qëndron.

Në anën tjetër, në faqen 17 të Draft Strategjisë thuhet se “Zhvillimet e fundit në sektorin e mediave kanë dëshmuar gjithashtu rëndësinë e bërjes transparente të pronësisë përfituese edhe në media”. Në rastin konkret, ka një pshtjellim në mes të dy koncepteve: Pronarit përfitues dhe pronësisë së mediave.

Çështjet të cilat lidhen me pronarin përfitues, kryesisht kanë për qëllim parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (shih për më shumë, [Pronësia përfituese e personave juridik](#)). Në anën tjetër, çështja e pronësisë mediale ndërlihdet me nevojën për parandalimin e monopolit në tregun medial, në mënyrë që të jetësohet pluralizmi medial. Për këtë arsye, në Draft Strategji duhet të dallohen këto dy koncepte.

Tutje, në këtë pjesë të Draft Strategjisë thuhet se “...Kemi dëshmuar zhvillimet e fundit ku një media e caktuar ka transmetuar lajmin se terroristi (i cili mori pjesë në sulmin në Banjskë në veri të Kosovës) ishte lavdëruar në Serbi...”. Lidhur me këtë rast, është pozitive se kanë funksionuar mekanizmat, në atë mënyrë që Komisioni i Pavarur i Mediave ka ndërmarrë veprimet e përcaktuara me ligj<sup>1</sup>. Përtej kësaj, nuk ka se si të veprohet ndryshe. Citimi i vetëm një rasti, për të cilin institucionet kanë vepruar në përputhje me kompetencat kushtetuese dhe ligjore, nuk ndërton asnjë argument të vlefshëm lidhur me ndonjë problem eventual të evidentuar, që do të mund të paraqiste dukuri. Për këtë arsye, IKD rekomandon që kjo pjesë dhe pjesët e tjera të kësaj natyre të largohen nga Draft Strategjia.

---

<sup>1</sup> <https://betimiperdrejtesi.com/kpm-merr-vendim-per-ndalimin-e-transmetimit-te-kanaleve-te-arenas-qe-shfaqen-mesazhe-kercenuese/>

### **15. Plani i veprimit**

Në Planin e Veprimit të Draft Strategjisë janë përcaktuar aktivitetet që synohet të ndërmarrën. Mirëpo, në draftin e dorëzuar nuk janë përcaktuar edhe Institucionet Përgjegjëse për zbatimin e këtyre aktiviteteve, harku kohor dhe kosto. Këto rubrika në draftin e pranuar janë të zbrazëta.

Me qëllim të dhënies së mundësisë për dhënie komente meritore, Plani i Veprimit të Draft Strategjisë duhet të përmbajë edhe këto të dhëna, mbi bazën e të cilave më pastaj do të draftohen komentet.

## 16. Rekomandime:

1. Nisur nga fakti se strukturat paraprake kanë dështuar të hartojnë Strategjinë brenda afatit të përcaktuar nga Qeveria, kjo e fundit të nxjerr vendim të ri për hartimin e Draft Strategjisë.
2. Hartimi i Strategjisë të bëhet duke respektuar Kushtetutën dhe konceptet bazë të rendit kushtetues kosovar.
3. Qeveria të ri hartoj nga pika zero Draft Strategjinë.
4. Draft Strategjia mos të cenojë pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe mos të përmbajë gjuhë që nxit mos besim ndaj institucioneve të sistemit të drejtësisë.
5. Hartimit të Strategjisë ti paraprijë një analizë e problemeve dhe jo të paraqiten të dhëna të pambështetura në fakte dhe argumente.
6. Draft Strategjia të jetë e bazuar në të dhëna të sakta analitike dhe përmbajtësore.
7. Draft Strategjia të jetë në harmoni me Strategjinë për Sundim të Ligjit.
8. Hartimi i Strategjisë të bëhet në konsultim meritator me të gjithë akterëve relevant, përfshirë edhe partnerët ndërkombëtar.
9. Institucionet e mandatuara për hartimin e Draft Strategjisë të analizojnë çështjet, në atë mënyrë që në Draft Strategji mos të inkorporohen çështje të cilat aktualisht janë të rregulluara me ligj.
10. Draft Strategjia ti nënshtrohet procesit të konsultimeve publike, në përputhje me Rregulloren për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik.
11. Qeveria të miratoj Strategjinë Shtetërore dhe Planin e Veprimit kundër Korrupsionit.